VENDIM
Nr. 28, datë 17.1.2018

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË MENAXHIMIT TË AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, i cili do të kryesohet nga z. Artan Shkreli, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe në përbërje të tij të ketë këta anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:
   a) Z. Elton Haxhi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
   b) Z. Gentian Opre, Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
   c) Z. Julian Hodaj, Ministria e Brendshme;
   ç) Z. Luigj Aleksi, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë;
   d) Z. Kujtim Hashorva, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;
   dh) Z. Faruk Kaba, Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet e planifikuara për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
3. Vendimi nr. 1010, datë 13.11.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar", i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama